



FINANCAT PUBLIKE VENDORE

Analiza e Treguesve Financiare të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Janar - Qershor 2020

I. Përmbledhje

Procesi i menaxhimit të financave publike në nivel vendor hyri në një fazë të re konsolidimi nën regjimin e ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në vijimësi të këtij regjimi, projekti “Financat Locale” në mënyrë të vazhdueshme ka realizuar analiza mbi treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor me qëllim monitorimin dhe asistencën e njësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Nisur nga ky objektiv, por edhe nevoja për të evidentuar mënyrën se si institucionet e vetëqeverisjes vendore po përballojnë gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19, projekti “Financat Locale” ka realizuar një analizë të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës për 6 mujorin e parë të vitit 2020 në nivel kombëtar por dhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Të dhënat janë marrë nga publikimet zyrtare të treguesve fiskalë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Gjetjet kryesore të kesaj analize 6-mujore janë përmbledhur si më poshtë:


- Në këndvështrimin e shifrave, paqëndrueshmërisë fiskale dhe “shokut” që përsuan shpenzimet publike, viti 2020 duhet të konsiderohet një vit i veçantë e përjashtimor për treguesit e menaxhimit financiar të pushtetit vendor.
- Të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë përsuar një rënie prej 24% krahasuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, dhe janë realizur në masën 77% të planit 6 mujor prej 13.2 miliard lekë.
- Në shumicën e 61 bashkive janë miratuar ndryshime në paketat fiskale në drejtim të uljes së barrës fiskale për familjet dhe bizneset në periudhën e pandemisë, si dhe shtyrjen e afateve të likuidimit të detyrimeve për gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020.
- Shpenzimet e qeverisjes vendore kanë një rënie të konsiderueshme prej 23% në 6 mujorin e parë të 2020 në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Shpenzimet për investime janë ulur me 57%, ato operative me 6%, ndërkohë që ka një rritje të lehtë të shpenzimeve të personelit.
- Gjatë 6 mujorit të parë 2020, në totalin e shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë shpenzimet për shërbimet e përgjithshme publike me rreth 25% të totalit, ndërkohë që parë në këndvështrimin e situatës së pandemisë dy nga programet të cilat duhet të ishin në rritje si peshë ndaj totalit të shpenzimeve janë ato të shëndetësisë dhe mbrotjes sociale, zënë një peshë mjaft të vogël me rreth 4% të të gjithë totalit të shpenzimeve vendore.

II. Të ardhurat e Pushtetit Vendor

Të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë pësuar një rënie prej 24% krahasuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, duke u realizur në masën 77% të planit 6 mujor. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në nivelin e të ardhurave vendore. Pothuajse të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë rishikuar paketat fiskale në drejtim të shtyerjes së detyrimeve tatimore për biznese dhe familje. Politikat fiskale të njësitë të vetëqeverisjes vendore në tërësi janë karakterizuar nga ndryshime të shpeshta, një pjesë të imponuara edhe nga aktet ligjore rregulluese të qeverisë qendrore. Në shumicën e 61 bashkive ndryshime në paketat fiskale synuan drejt uljes së barrës fiskale për familjet dhe bizneset si dhe shtyerjes së afatit të pagesës përgjatë 6 mujorit të dytë. Ndryshimet ligjore kanë shfuqizuar paradhëniet për Tatimin e thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël. Si pasojë vërehet një tendencë ulje në eficientësi të mbledhjes së të ardhurave, me një efekt të drejtpërdrejtë në arkën e njësitë të vetëqeverisjes vendore.

Për 6 mujorin e parë të vitit 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura në masën 10.2 miliard lekë, shifër kjo që është rreth 3.2 miliard lekë më pak se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2019. Duke marrë në analizë të njëjtën periudhë të 10 viteve të fundit, dukshëm vërehen që të ardhurat e veta vendore kanë pësuar rritje, përjashtuar këtu vitin aktual 2020. Si më poshtë, paraqiten të ardhurat nga burimet e veta vendore në 6 mujoret në vite.


Grafiku 1: Të ardhurat e 6 mujorit të parë e nga burimet e veta të pushtetit vendor



Edhe në raport me planin e periudhës konstatohet që ka një mosrealizim të të ardhurave të pushtetit vendor dhe ky mosrealizim është afërsisht rreth 2.3 miliard lekë ose 23% më pak se plani i miratuar 6 mujor prej 12.5 miliard lekë.

Taksat lokale përbejnë rreth 74.8% të shumës totale të ardhurave vendore trend ky i njëjtë me vitin 2019 ku pesha ishte rreth 75%. Në vijim është zhvilluar një analizë e zërave kryesore të burimeve të të ardhurave të pushtetit vendor në gjysmën e parë të viteve të fundit, si më poshtë vijon:

Grafiku 2: Të ardhurat e 6 mujorit të parë sipas burimit për njësitë vendore




Taksa mbi Pasurinë është mbledhur rreth 22% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019.

Taksa mbi pasurine përbën një ndër shtyllat më të rëndësishme dhe të qëndrueshme mbi të cilën duhet të mbështeten financat publike në nivel vendor. Ndërkohë që në vite është shpallur objektivi i krijimit të një burimi të qëndrueshëm për të ardhurat vendore nga taksa mbi pasurinë, akoma mbetet problematik ky burim për NJVQV-të. Implementimi i metodologjisë së re në bazë vlere, në shumë njësi po has vështirësi të mëdha, duke u kthyer në një ngërç të zgjatur në kohë për të ardhurat vendore.

Për 6 - mujorin e vitit 2020 kjo taksë është mbledhur në vlerën 2.2 miliardë lekë, ose rreth 22% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019. Problematikat që kanë ndjekur implementimin e këtij burimi të të ardhurave vendore lidhen jo vetëm me situatën e pandemisë COVID-19 të këtij vitit, por dhe me ineficencën e institucioneve përgjegjëse qendrore për të asistuar NJVQV-të në implementimin e plotë. Hartimi i plotë i kadastrës fiskale dhe implementimi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbetet një sfidë e objektiv për tu arritur në vitet në vazhdim si për qeverisjen qendrore ashtu edhe për vetë NJVQV-të. Një rënie e tillë gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020 në të ardhurat nga taksa mbi pasurinë do të duhet të rikuperohet në afatshkurtër me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.


Grafiku 3: Të ardhurat e 6 mujorit të parë nga taksa mbi pasurinë



Te ardhurat nga taksat e biznesit të vogël janë rritur me 10%. Taksa e biznesit tashmë është burimi më i ulët i të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore me vetëm 3.2% të totalit të të ardhurave në 6 mujorin e parë 2020. Duke marrë në krahasim me të gjithë burimet e tjera konstatohet që taksa e biznesit të vogël është i vetmi burim që ka ardhur në rritje pamvarësisht situatës pandemike të krjuar që afektoj të gjithë burimet e tjera vendore. Taksa e biznesit të vogël janë mbledhur 331 milion lekë, pra rreth 30 milionë lekë më shumë se një vit më parë ose ndryshe me një ritëm rritje rreth 10%. Pamvarësisht situatës së pandemisë, rritja e të ardhurave nga ky burim vjen për shkak të faktit që detyrimi i taksës llogaritet nga aktiviteti i bizneseve në vitin e mëparshëm dhe paguhet kryesisht brenda 3 mujorit të parë të vitit, duke u akumuluar këto të ardhura para fillimit të efektit real të pandemisë COVID-19 në ekonomi. Kjo taksë zë një peshë mjaft të vogël në të ardhurat vendore dhe si rrjedhim ritmi i rritjes së tyre ka një ndikim të vogël në burimet e veta të të ardhurave vendore.


Taksa e biznesit të vogël është një burim që ndër vite ka ardhur në rënie si raport i peshës që zë në të ardhurat vendore. Ulja e të ardhurave nga kjo takse në raport me vitin 2015 vjen si rezultat i ndryshimeve ligjore të ndodhura në vitë, ku subjektet me një xhiro nga 0-5 milionë lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor ndërsa ato me xhiro 5-8 milionë kanë përfituar një reduktim me 2.5% të shkallës tatimore, ndryshime të cilat kanë afektuar drejtpërdrejt të ardhurat vendore. Pavarësisht pretendimeve të qeverisë qendrore për një kompensim të këtij efekti negativ, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kundërshtuar vazhdimisht që kompensimi nuk ka qënë në masën e kërkuar nga ligji. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë në 6 mujorin e vitit 2020 janë realizuar rreth 30 milion lekë të ardhura më shumë nga taksa e biznesit të vogël, edhe pse ky burim ka ndikim relativisht të vogël i të ardhurave vendore.

Grafiku 4: Të ardhurat e 6 mujorit të parë nga taksa mbi biznesin e vogël



Taksat të tjera lokale, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm të financimit të aktivitetit të pushtetit vendor kanë patur një ecuri pozitive në 10 vitet e fundit duke konsoliduar trendin në rritje deri në vitin 2020. Rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja pas reformës administrative dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale ka rritur mbledhshmërinë e këtyre taksave pas vitit 2015 duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Viti 2020, si pasojë e situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, është një pikë kthesë për këto burime për shkak të referuar 6 mujorit 2020 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 7.6 miliardë lekë, ose rreth 2.4 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë ose ndryshe rreth 24% më pak.

Grafiku 5: Të ardhurat e 6 mujorit të parë nga taksa të tjera lokale



Më poshtë paraqiten të detajuara ndryshimet sipas burimit të të ardhurave në 6 mujorin e parë 2020 dhe krahasur me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, situata e pandemisë ka ndryshuar peshën që këto burime zënë në totalin e të ardhurave të akumuluar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

ne milion leke

BURIMI I TË ARDHURAVE VENDORE	6 mujori 2020	6 mujori 2019	% e ndryshimit	Pesha 2020	Pesha 2019
Takse e efektit infrastrukture nga ndertimet e reja	3,736	4,753	-21.40%	33.42%	32.43%
Tarifa Pastrimi	1,778	2,363	-24.76%	15.91%	16.13%
Takse Ndertese	1,706	2,622	-34.95%	15.26%	17.89%
Taksa te tjera	1,667	2,125	-21.56%	14.91%	14.50%
Te Ardhura Jotatimore	942	1,195	-21.21%	8.43%	8.16%
Takse Biznesin Vogel	331	301	9.94%	2.96%	2.05%
Takse zenie hapësirave publike	261	326	-20.02%	2.33%	2.23%
Takse tranaksioneve imobiliare	230	280	-18.00%	2.05%	1.91%
Takse mbi Token	211	221	-4.46%	1.89%	1.51%
Takse table	189	271	-30.30%	1.69%	1.85%
Taksa e gjelbert	91	130	-30.05%	0.81%	0.89%
Takse fjetje ne hotel	37	67	-44.42%	0.33%	0.46%
TOTALI	11,177	14,653	-23.73%	100.00%	100.00%

Tarifat Vendore, jane një element i rëndësishëm i te ardhurave vendore qe kane pasure nje rënie mbi 30% krahasuar me te njejtën periudhë te 2019.

Tarifa e pastrimit, pavarësisht nevojës në rritje për shërbime pastrimi dhe sanitare gjatë pandemisë, kane patur nje rënie të ndjeshme me rreth 24.7% në vitin 2020. Në vlerë absolute këto të ardhura janë realizuar në masën rreth 1.7 miliard lekë ose rreth 600 milion lekë më pak se e gjashtëmujori i parë i vitit 2019.

Të ardhurat jotatimore që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet që marrin qytetarët nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë gjashtë mujorit të vitit 2020 kanë pësuar një rënie të pritshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 me rreth 21% më pak. Në vlerë absolute arkës së njësive nga këto të ardhura jotatimore në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 i mungojnë rreth 300 milion lekë krahasuar me një vit më parë. Rënia e nivelit të të ardhurave nga tarifat për shërbimet publike lidhet me pezullimin e aktivitetit ekonomik në mënyrë të ndjeshme në 6 mujorin e parë të vitit 2020. Mbyllja e aktiviteteve ka bërë që shumë qytetarë mos ti marrin këto shërbime dhe sigurisht është reflektuar në rënie të të ardhurave nga ky burim për njësitë e vetëqeverisjes vendore.


III. Shpenzimet e pushtetit vendor

Viti 2020 për financat vendore ashtu si për financat publike në tërësi do të konsiderohet si viti i paqëndrueshmërisë fiskale në këndvështimin e shokut që pësuan shpenzimet publike. Niveli i shpenzimeve të gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020 është ndikuar në një masë të madhe si pasojë e situatës së pandemisë COVID-19. Një tjetër faktor frenues për njësitë e vetëqeverisjes vendore ishte vendosja nën regjimin e kufizuar të shpenzimeve / pagesave gjatë periudhës së pandemisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me qëllim kontrollin e gjendjes së likuiditetit, duke krijuar kështu stok të faturave në pritje për tu paguar. Sidoqoftë, duhet theksuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore në gjysmën e parë të vitit 2020 kanë një meritë të veçantë në përballimin e situatës së krijuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike.

Shpenzimet e qeverisjes vendore kanë një rënie prej 23% në 6 mujorin e parë të 2020 në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që pjesa më e madhe e rënies vërehet në shpenzimet për investime që janë ulur me 57%. Niveli i shpenzimeve është një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe tendencave zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Pamvarësisht se është synuar rritja e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me shpenzimet totale të buxhetit qendror apo ndaj produktit të brendshëm bruto, pesha specifike e tyre vazhdon të jetë në një vlerë të vogël. Në 6 mujorin e parë të vitit 2020 në totalin e shpenzimeve publike prej rreth 219.3 miliard lekë, shpenzimet e pushtetit vendor prej rreth 22.2 miliard lekë zënë vetëm 10% të tij. Ky fakt deshmon një nivel të ulët të decentralizimit fiskal.


Në tërësi, të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë rënie në raport me 6 mujorin e vitit 2019, por duhet të theksohet fakti që pjesa më e madhe e rënies së shpenzimeve të pushtetit vendor i përket shpenzimeve për investime, ndërkohë që ka një rritje të lehtë të shpenzimeve të personelit. Rialokimet e shumta buxhetore kanë synuar mbështetjen me fonde të programeve që lidhen më shëndetësinë dhe pastrimin e dizifektimin e qytetit.

Grafiku 6: Shpenzimet e 6 mujorit të parë në vite të pushtetit vendor



Në raport me 6 mujorin e vitit 2019 kemi një ndryshim në rënie prej rreth 7 miliard lekë të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor, shifër kjo e konsiderueshme për strukturën e shpenzimeve të qeverisjes vendore e thënë ndryshe rreth 23% më pak. Në vitin 2020 shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të lehtë në raport me një vit më parë me rreth 246 milion lekë më shumë, rritje kjo e cila nuk ka një ndikim të ndjeshëm në strukturën e shpenzimeve. Gjatë 6 mujorit të vitit 2020 konstatohet rënie në zërin shpenzime operative të pushtetit vendor në raport me një vit më parë. Rëna drastike e shpenzimeve për investime tregon qartë situatën e vështirë ekonomike që me të cilën e përballën investimet publike si pasojë e bllokimit në 3 mujorin e dytë të vitit 2020. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë goditur vecanerisht në drejtim të volumit të punëve publike të cilat ato duhet të kryejnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Si rrjedhim këto ndryshime kanë ulur peshën e shpenzimeve për investime me rreth 19.4% të totalit të shpenzimeve , dhe më pas vjen zëri për paga dhe sigurime me rreth 49.8%.

Grafiku 7: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas llogarive ekonomike



Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 6 mujorit të vitit 2020 dhe vitit 2019.

Tabela 1: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milion lekë)				
Diferenca				
EMËRTIMI	6 mujori 2020	6 mujori 2019	2020 /2019	% e 2020 kundrejt 2019
Të ardhura nga Pushteti vendor	10,236	13,458	-3,222	76%
<i>Taksa mbi pasurinë</i>	2,248	3,126	-879	72%
<i>Taksa e biznesit të vogël</i>	331	301	30	110%
<i>Taksa Lokale</i>	7,657	10,031	-2,373	76%
Shpenzime nga Pushtetit Vendor	22,220	29,156	-6,936	76%
Shpenzime Korente	17,915	19,074	-1,159	94%
<i>Personeli</i>	11,076	10,830	246	102%
<i>Shpenzime Oper. Mirmbajtje</i>	6,086	7,613	-1,527	80%
<i>Subvencione</i>	68	71	-3	96%
<i>Te tjera</i>	685	559	125	122%
Shpenzime Kapitale	4,305	10,082	-5,777	43%

Shpenzimet per investime kanë pësuar një rënie drastike ne 6 mujorin e pare te 2020, duke ulur në këtë mënyrë edhe një ndër shpenzimet më të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me 6 mujorin e parë të vitit 2019, gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2020 shpenzimet për investime kanë patur një rënie në vlerën rreth 5.7 miliard lekë më një rënie në masën 57% krahasuar me të njëjtën periudhë të viti 2019. Rënie në shpenzime për investime publike kanë pësuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Vijimesia e kësaj tendence rënëse të shpenzimeve për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në vepra infrastrukturore dhe punë publike në interes do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e produktivitetit të ekonomisë kombëtare.

Shpenzimet e Personelit, janë realizuar në masën 11 miliard lekë ose rreth 246 milion lekë, mbi 2% më shumë se e njëjta periudhë e vitit **2019**. Duke konsideruar faktin që gjatë vitit 2020 nuk ka patur politikë të re në rritjen e pagave, vlerësojmë si të pajustificuar një rritje e shpenzimeve të personelit në një periudhë pandemie e krize të përgjithshme ekonomike. Tashmë shpenzimet e personelit kanë marrë një natyrë të qënderueshme në vite, tregues ky që reflekton mbylljen e periudhës tranzitore të konsolidimit të njësisve të reja vendore. Rritja e shpenzimeve të personelit është thujse një trend në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe nga viti në vit, si rrjedhim është i nevojshëm një vlerësim të politkave të personelit që kanë përdoror NJVQV-të pas reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit të disa prej funksioneve.

Shpenzimet Operative rezultojnë me një rënie të ndjeshme, **rreth 20%** në 6 mujorin e parë të **vitit 2020** edhe pse shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve në kushtet e perballimit të krizës së COVID 19. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 27.4% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor për 6 mujorin e parë të vitit 2020 dhe 26% të këtyre shpenzimeve për vitin 2019. Në vlerë absolute në 6 mujorin e parë të vitit 2020 janë shpenzuar rreth 6 miliard lekë ose e thënë ndryshe rreth 1.5 miliard lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një vitit më parë. Ky ndryshim i shpenzimeve operative nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë 6 mujorit të parë 2020 lidhet kryesisht me punën nën kapacitete të reduktuara që kanë operuar NJVQV-të gjatë periudhës së pandemisë. Pamvarësisht ndryshimit në rënie gjatë vitit 2020, në tërësi vihet re tendenca e rritjes nga viti në vit i shpenzimeve operative, shpenzime të cilat nuk justifikojnë aktivitetin që kanë përcaktuar në strategjitë zhvillimore të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Shpenzimet për subvencione dhe shpenzime të tjera, janë shpenzimet që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikat e ndryshme vendore dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në 6 mujorin e parë të vitit 2020 shpenzimet për subvencione patën një rënie me vlerë minimale rreth 4 milion lekë ose ndryshe me rreth 2% krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa shpenzimet e tjera janë rritur me rreth 125 milionë lekë ose ndryshe me rreth 22% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke parë peshën që shpenzimet e kësaj natyre në totalin e shpenzimeve buxhetore që realizojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, konstatohet roli shumë i vogël i plotikave subvencionuese që kanë përdorur njësitë e pushtetit vendor për të ndihmuar ecurinë ngeative të biznesit dhe familjeve gjatë pandemisë së COVID-19. Roli shumë i vogël që ka buxheti vendor në raport me shpenzimet publike dhe produktin e brendshëm bruto reflektohet edhe në potencialin për të zhvilluar politika subvencionimi që ngelet mjaft i kufizuar.

Shpenzimet sipas natyrës funksionale nga njësive të vetëqeverisjes vendore, janë ndikuar ndjeshëm si rezultat i situates emergjente për të perballuar COVID 19. Gjatë 6 mujorit të parë 2020, në totalin e shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë shpenzimet për shërbimet e përgjithshme publike me rreth 25% të totalit. Dy nga programet të cilat duhet të ishin në rritje si peshë ndaj totalit të shpenzimeve janë ato të shëndetësisë dhe mbrotjes sociale. Nga analiza konstatohet që këto shpenzime të buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore ka zënë një peshë mjaft të vogël ose rreth 4% të të gjithë totalit të shpenzimeve vendore.

Grafiku 8: Shpenzimet sipas funksioneve në 6 mujorin e parë 2020




Tabela e mëposhtme paraqitet ndryshimet në shpenzimet sipas 9 funksioneve të vetqeverisjes vendore. Nga tabela, konstatohen qartë levizjet e politikave të realizimit të buxhetit vendor gjatë gjashtëmujtorit të parë të vitit 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të një vitit më parë.

ne milion leke

Funksioni	6 mujori 2019	6 mujori 2020	% e ndryshimit	Peshat 2019	Peshat 2020
01-Shërbimet e Përgjithshme Publike	6,470	5,456	-15.68%	22.07%	24.55%
03-Rendi dhe Siguria Publike	703	1,281	82.22%	2.40%	5.76%
04-Çështjet Ekonomike	7,243	3,907	-46.06%	24.70%	17.58%
05-Mbrjotja e Mjedisit	886	1,690	90.74%	3.02%	7.61%
06-Strehimi dhe Kom. e komunitetit	6,133	3,773	-38.48%	20.92%	16.98%
07-Shëndetësia	10.3	15.6	51.12%	0.04%	0.07%
08-Argëtimi, Kultura, Feja	1,374	961	-30.05%	4.69%	4.33%
09-Arsimi	5,598	4,502	-19.58%	19.09%	20.26%
10-Mbrojtja Sociale	903	635	-29.69%	3.08%	2.86%
TOTALI	29,321	22,220	-24.22%	100.00%	100.00%

Shërbimet e Përgjithshme Publike gjatë vitit 2020 kanë pësuar një rënie me rreth 15.6 % më pak se e njëjta periudhë e një vitit më parë, por nga ana tjetër NJVQV-të kanë rritur peshën e kësaj natyre shpenzimi në raport me totalin e shpenzimeve nga 22% në 6 mujorin e parë të vitit 2019 në 24% të të njëjtës periudhë të vitit 2020. Funksioni i **Rendit dhe Sigurisë**

Publike së bashku me **Mbrojtjen e Mjedisit** dhe **Shëndetësinë** janë të vetmet funksione që gjatë kësaj periudhe kanë pësuar rritje si në vlerë absolute ashtu edhe në peshën që zënë në totalin e shpenzimeve publike. Rritja e këtyre shpenzimeve, referuar kryesisht atyre të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetësisë lidhet drejtpërdrejt me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe masave të njësisive të vetëqeverisjes vendore në përmirësimin e situatës së krijuar në dizifektim dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të kujdesit parësor.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë ulur ndjeshëm gjatë 6 mujortë të parë 2020 në krahasim me të njëjtën periudhë të një vitit më parë, por edhe mbi totalin e shpenzimeve, shpenzimet për funksionet e **Çështjeve Ekonomike, Strehimit, Argëtimit, Arsimit** dhe **Mbrojtjes Sociale**. Rënien më të madhe e kanë pësuar shpenzimet për Çështjet Ekonomike me rreth 2.4 miliard lekë (46%) dhe Shëndetësinë (51.2%) më pak se e njëjta periudhë e një vitit më parë. Ky ndryshim sigurisht që në vlerësimin afatshkurtër është realizuar për të përballuar emergjencat e pandemisë, por në afatgjatë do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në tendencat zhvillimore të ekonomisë lokale por edhe asaj kombëtare.

Gjate kësaj periudhe ka pasur rialokime të shumta të shpenzimeve dhe transparencë të ulët të vendimeve të Këshillave Bashkiakë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, si pasojë edhe e situatës së krijuar njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë realizuar një numër relativisht të lartë rialokimesh por edhe ndryshimesh buxhetore e fiskale. Këto ndryshime në shumicën e rasteve janë jotransparente dhe të vështira për tu aksesuar nga publiku apo grupet e interesit. Në këtë drejtim vlerësojmë të domosdoshme rritjen e cilësisë së planifikimit në programin buxhetor afatmesëm dhe gjithashtu hartimin e formave që rrisin transparencën dhe aksesin në informacionin financiar të njësisive të vetëqeverisjes vendore.